



KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË  
VERIUT  
INSTITUTI PARLAMENTAR

---

*Punëtori me temë*

**PARLAMENTI I FËMIJËVE**

*për nxënësit e  
shkollave fillore në Republikën e Maqedonisë së Veriut*

Përmbajtjet për këtë punëtori janë zhvilluar dhe realizuar nga Njësia për Edukim dhe Komunikim e Institutit Parlamentar të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

## **Informacione të përgjithshme:**

Instituti Parlamentar është njësi e veçantë organizative në Shërbimin e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut që funksionon si një qendër për hulumtim, edukim dhe informim, i themeluar mbi parimet e paanshmërisë, arritshmërisë dhe kredibilitetit.

Instituti Parlamentar, ndër të tjera, kryen aktivitete për edukim dhe informim të qytetarëve për punën dhe rolin e Kuvendit (në përputhje me qëllimin e tij strategjik për Parlament të hapur).

Në këtë drejtim, gjatë vitit, është planifikuar të organizohen dy punëtori nga shkollat fillore në Republikën e Maqedonisë së Veriut me temë **“Parlamenti i fëmijëve”**, nga një në çdo gjysmëvjetor. Parlamenti i fëmijëve është një program i veçantë i Njesisë për Edukim dhe Komunikim të Institutit Parlamentar që do të realizohet si një punëtori në kohëzgjatje prej pesë orë e gjysmë. Punëtorja u dedikohet nxënësve nga klasa IX të cilët mësojnë përmbajtje në lidhje me menaxhimin e shoqërisë dhe pushtetin në Republikën e Maqedonisë së Veriut në lëndën "Shoqëria civile".

## **Përshkrimi i punëtorisë “Parlamenti i fëmijëve”**

Punëtorja është paramenduar të realizohet si një seminar në kohëzgjatje prej pesë orë e gjysmë. Gjatë punëtorisë, nëpërmjet sesioneve interaktive dhe ushtrimeve praktike, nxënësit do të kenë mundësi t'i përcaktojnë njohuritë e tyre për demokracinë, punën e Kuvendit, të drejtat dhe obligimet e deputetëve, si dhe të fitojnë shkathtësi për diskutim dhe prezantim të argumenteve të tyre.

Punëtorja fillon me vizitë të organizuar në pjesën solemne të Kuvendit, që përfshin vizitë të Sallës Maqedonia (Salla Plenare), Sallës Boris Trajkovski, Sallës së Ohrit, Sallës së Drugdhjendjes së thellë dhe hapësirave të tjera. Nëpërmjet vizitës, pjesëmarrësit kanë mundësinë që nga afër të njihen me hapësirën në të cilën punojnë deputetët në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Sesioni i parë përfshin takim me deputetët në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, kështu që nxënësit kanë mundësi që në takim të drejtpërdrejtë t'u parashtrojnë pyetje dhe të bisedojnë me deputetët për punën dhe rolin e tyre në procesin demokratik të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në mënyrë që nxënësit nga të gjitha shkollat të kenë mundësinë të parashtrojnë një pyetje, secila prej shkollave që do të ftohet të merr pjesë, emëron një nxënës i cili do t'ua parashtojë pyetjen deputetëve. Pas përfundimit të listës së nxënësve të nominuar, secili pjesëmarrës do të ketë mundësi të parashtojë një pyetje sipas parimit "i pari i paraqitur" "i pari i shërbyer", deri në fund të kohës së parashikuar për sesionin.

Si pjesë e përgatitjeve për pjesëmarrje në Parlamentin e fëmijëve, pjesëmarrësit kanë për obligim të përgatitin një pano me porosi për deputetët të shprehur nëpërmjet një mendimi, vargu ose vizatimi. Në këtë mënyrë nxënësit do të kenë mundësi ta zhvillojnë kreativitetin e tyre. Gjatë punëtorisë, panoat e përgatitura do të prezantohen para pjesëmarrësve të tjerë dhe para deputetëve të pranishëm.

Pjesa kryesore e Parlamentit të fëmijëve është konceptuar si simulim (lojë me role) i një seancë të Kuvendit, ku në rolin e deputetëve do të jenë vetë nxënësit. Loja me role nxënësve u jep një mundësi të jashtëzakonshme që të ndiejnë si është të jesh ligjvënës, të "futen në këpucët e deputetëve", të diskutojnë dhe të votojnë për një zgjidhje të caktuar ligjore. Në këtë mënyrë, nxënësit do të zgjerojnë njohuritë e tyre rreth debatit, duke u përpjekur të gjejnë argumente të qëndrueshme që do të mbështesin ose hedhin poshtë zgjidhjen e ofruar. Me këtë, nxënësve u mundësohet të zhvillojnë shkathtësitë e tyre komunikuese dhe retorike. Në mënyrë që nxënësit nga të gjitha shkollat të kenë mundësinë të përfshihen në debat, secila prej shkollave që do të ftohen të marrin pjesë, emëron një nxënës i cili do ta prezantojë qëndrimin e tij para pjesëmarrësve të tjerë. Pas përfundimit të listës së nxënësve të nominuar, secili pjesëmarrës do të ketë mundësi të paraqitet për fjalë sipas parimit "i pari i paraqitur" "i pari i shërbyer", deri në fund të kohës së parashikuar për sesionin.

Të gjithë nxënësve që janë pjesë e Parlamentit të fëmijëve, si dhe mësimitdhënësve të cilët do t'i shoqërojnë nxënësit, do t'u jepet certifikatë për pjesëmarrje.

- Qëllimet e përgjithshme punëtorisë:** Afrimi i punës së Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut te popullata e re, që do të kontribuojë në zhvillimin e ndërgjegjësimit të tyre për demokracinë dhe të drejtat e njeriut dhe do t'i inkurajojë dhe përgatitë ata për kritikë dhe përfshirje shoqërore dhe politike.
- Numri i pjesëmarrësve** 15 shkolla, numri i pjesëmarrësve nga një shkollë është katër nxënës dhe një mësimdhënës.
- Koha:** Dy herë në vit
- Vendi:** Salla “Boris Trajkovski”, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut
- Gjuha:** Gjuha maqedonase me përkthim në gjuhën shqipe
- Trainues:** Punëtorja do të realizohet nga trajnuesit e Njesisë për Edukim dhe Komunikim në Institutin Parlamentar.
- Shpenzime:** Pjesëmarrja në punëtori është falas dhe përfshin materiale edukative falas, ushqim dhe pije freskuese gjatë punëtorisë. Shpenzimet e transportit nga dhe deri në vendin e punëtorisë i mbulojnë vetë pjesëmarrësit.
- Mënyra e paraqitjes:** Çdo shkollë që do të paraqitet, emëron katër nxënës të cilët do të marrin pjesë në punëtori dhe një mësimdhënës i cili do t'i shoqërojë. Paraqitja bëhet nëpërmjet platformës softuerike për paraqitje: [seminari.sobranie.mk](http://seminari.sobranie.mk)
- Kontakt:** E-mail: [parl.inst@sobranie.mk](mailto:parl.inst@sobranie.mk)  
tel: 02/3182 – 227

**Qëllimet e përgjithshme të punëtorisë:**

Në fund të punëtorisë, pjesëmarrësit do të kenë mundësi:

- të njihen me hapësirën në të cilën punon Kuvendi;
- t'i identifikojnë kompetencat themelore të Kuvendit dhe të kenë pasqyrë themelor për procesin e miratimit të ligjeve;
- të njihen me të drejtat dhe obligimet e profesionit të deputetit;
- të fitojnë njohuri më të gjera nga sfera dhe temat që debatohen;
- të fitojnë shkathtësi për diskutim dhe prezantim me sukses të argumenteve të tyre;
- të kuptojnë çfarë do të thotë të jesh qytetar aktiv në shoqëri dhe si mund të kontribuojnë në proceset demokratike të vendit.

Për arritjen e këtyre qëllimeve, punëtorja do t'i përfshijë këto **përmbajtje**:

<b>Përmbajtje</b>	<b>Kohëzgjatja</b>
Vizitë e organizuar në ndërtesën e Kuvendit	60 minuta
Takim me deputetë	50 minuta
Prezantim i panoave kreative - mesazh për deputetin i shprehur nëpërmjet një mendimi, vargu, vizatimi	45 minuta
Lojë me role - roli i deputetit me temë "Zëvendësimi i librave klasik me ato elektronic"	90 minuta
Vlerësim i punëtorisë dhe dhënia e certifikatave për pjesëmarrje	30 minuta